

2. Zhvillimet makroekonomike në Shqipëri

2.1 Sektori i ekonomisë reale

Ekonomia vendase u zgjerua me 1.7% për tremujorin e parë të vitit 2013 në terma vjetorë. Sektori i industrisë shënoi një rritje prej 14.8% duke dhënë kontributin më të lartë në rritjen ekonomike të kësaj periudhe, ndjekur nga sektori i bujqësisë me një rritje prej 2.1%, ndërkohë që sektori i shërbimeve është rritur me vetëm 0.9%. Ndonëse me ritme më të ngadalta, sektori i ndërtimit vijoi tkurrjen, duke rënë me 4.8% gjatë periudhës. Në sektorin e shërbimeve, postë-komunikacioni vijoi të kontribuojë pozitivisht, duke u rritur me 15.4%, ndërsa tregtia dhe transporti patën një tkurrje prej përkatësisht 2.1% dhe 2.9% në periudhën e analizuar.

Gjashtëmujori i parë i vitit u karakterizua nga një ecuri e dobët e kërkesës agregate. Stimuli fiskal dhe kërkesa e huaj kanë qenë kontribuesit kryesorë në rritjen ekonomike, ndërkohë që konsumi dhe investimet private kanë mbetur në nivele të ulëta. Ecuria e kreditimit ka treguar kërkesën e ulët të sektorit privat, si edhe kushte ende të shtrënguara nga ana e ofertës. Politika monetare ka vijuar të jetë stimuluese, përcjellja e së cilës synon mbështetjen e planeve të konsumit e të investimeve dhe performancën e kreditimit në vend, së bashku me stimujt makroprudencialë të dhënë nga Banka e Shqipërisë gjatë kësaj periudhe.

Ecuria e normës së inflacionit gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2013 rezultoi brenda objektivit, ndërkohë që presionet inflacioniste u paraqitën të ulëta. Inflacioni mesatar për këtë periudhë pati një normë prej 2.4%, me një diferencë negative prej 0.23 pikë përqindje me gjashtëmujorin paraardhës.

Bazuar në tregues të tërthortë¹⁴, situata e individëve filloi të shfaqë përmirësime në tremujorin e dytë të vitit. Treguesi i Besimit Konsumator u rrit me 5.7 pikë përqindje në këtë periudhë. Nga ana tjetër, standardet e kreditimit janë lehtësuar dhe kërkesa për kredi për individët ka dhënë shenjat e para të rigjallërimit.

Në tregun e punës, norma e papunësisë së regjistruar ka shënuar 12.8% në fund të tremujorit të dytë 2013, duke u ngushtuar me 0.27 pikë përqindje në terma vjetorë. Paga mesatare ka pësuar rritje në terma realë për periudhën, pas një periudhe dyvjeçare në rënie. Numri i të punësuarve është shtuar me 1.5% në terma vjetorë, duke reflektuar përmirësimin e sektorit privat jobujqësor, numri i të punësuarve të të cilit është rritur me 7.6% me bazë vjetore. Numri i të punësuarve në sektorin shtetëror ka vijuar të bjerë, duke ndryshuar me 0.5% në terma vjetorë, ndërkohë që një rënie prej 0.9% është shfaqur edhe nga sektori privat bujqësor. Pritshmëritë¹⁵ për punësimin në periudhën në vazhdim paraqiten më optimiste për sektorin e industrisë, vijnë të mbeten pozitive për sektorin e shërbimit dhe janë lehtësisht më pozitive edhe për atë të ndërtimit.

¹⁴ Sipas Vrojtimit të Besimit të Biznesit dhe Konsumatorit dhe Vrojtimit të Aktivitetit Kreditues.

¹⁵ Sipas Indeksit të Besimit të Biznesit për tremujorin e dytë të vitit 2013, treguesi i pritjeve për punësimin ka një vlerë prej 7.8 për sektorin e industrisë, 1.0 për sektorin e shërbimeve dhe 0.5 për sektorin e ndërtimit.

Treguesit fiskalë për fundin e gjashtëmujorit të parë të vitit tregojnë një politikë fiskale me karakter ekspansionist. Totali i të ardhurave ka rënë me 2.9% në terma vjetorë, me një vlerë prej 156.8 miliardë lekësh. Nga ana tjetër, shpenzimet kanë shënuar një vlerë prej 205.1 miliardë lekësh, me një normë rritjeje 12.2% krahasuar me një vit më parë, duke ndjekur ritmin rritës të gjithë kësaj periudhe. Duke marrë në konsideratë edhe peshën e tyre në totalin e të ardhurave, rënia e të ardhurave tatimore ka ndikuar në rënieën e nivelit të përgjithshëm të të ardhurave, pavarësisht ecurisë së mirë të të ardhurave jotatimore. Shpenzimet e përgjithshme janë ndikuar nga rritja e njëkohshme e shpenzimeve kapitale dhe e atyre korrente, të cilat kanë ndjekur ritme të larta të rritjes përgjatë gjithë gjashtëmujorit. Deficiti buxhetor ka reflektuar zgjerimin e stimullit fiskal të kësaj periudhe, veçanërisht në tremujorin e dytë të vitit, duke arritur në një nivel prej 48.2 miliardë lekësh në fund të gjashtëmujorit të parë 2013, ose 3.55% e PBB¹⁶-së. Financimi i tij është realizuar në një masë të madhe prej 79.1% nga burime të brendshme, pjesë e rëndësishme e të cilave ishin të ardhurat nga privatizimi, ndërkohë që vetëm 20.9% e tij është financuar prej burimeve të jashtme. Stoku i borxhit publik arriti një vlerë prej 871.5 miliardë lekë në fund të gjashtëmujorit të parë 2013. Kohëzgjatja mesatare e borxhit ka vijuar të rritet me ritme të shpejta përgjatë gjithë periudhës së analizuar, duke arritur në 457 ditë deri në maturim në fund të saj. Stoku i borxhit të brendshëm përbën 57.4% të stokut të borxhit publik.

Në fund të gjashtëmujorit të parë 2013, deficiti i llogarisë korrente u ngushtua me 4.2% në terma vjetorë, me një vlerë prej 519.4 milionë euro. Dërgesat e emigrantëve kanë patur një vlerë prej 226.8 milionë euro për periudhën, duke rënë me 32.9% krahasuar me gjashtëmujorin e parë 2012. Në këtë periudhë, deficiti i llogarisë korrente është financuar nga gjendja e llogarisë financiare dhe kapitale që arriti një vlerë prej 534.3 milionë euro, me një rënie vjetore prej 20.4%. Në këtë llogari, investimet u zvogëluan me 12.6% në terma vjetorë, duke regjistruar një vlerë prej 446.4 milionë euro për gjashtëmujorin. Ndërkohë, investimet e portofolit shënuan një përmirësim për periudhën, ndërsa investimet e tjera vijuan të bien.

Deficiti tregtar paraqitet i përmirësuar për gjashtëmujorin e parë 2013, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2012, duke u ngushtuar si pasojë e rritjes së eksporteve dhe rënies së importeve. Rritja e eksporteve ka pasqyruar kontributin pozitiv të kategorisë "Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike". Në fund të këtij gjashtëmujori, raporti i mbulimit të importeve me eksporte shënoi një vlerë prej 50.2% ose 11.9 pikë përqindje më tepër se një vit më parë.

Situata ekonomike e partnerëve tregtarë kryesorë pritet të ushtrojë presion mbi kërkesën e huaj dhe mbi dërgesat e emigrantëve. Stimuli fiskal pritet të jetë mjaft i kufizuar, ndërsa presionet inflacioniste pritet të mbeten të ulëta. Konsumi dhe investimet private do të vijojnë të reflektojnë pasiguritë për të ardhmen, duke ndikuar në ritmin e rritjes ekonomike.

2.2 Tregu i banesave

Zhvillimet në tregun e pasurive të paluajtshme shfaqin ndryshime lehtësisht pozitive gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2013, në krahasim me periudhën paraardhëse. Për këtë

¹⁶ Vlerësime paraprake të PBB-së.